



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES

PROJEKT

PËRMIRËSIMI DHE FUQIZIMI I PARKUT TE LANFILLIT

BASHKISE VAU DEJES

Shtojcë II:

FORMATI PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Institucioni (*)	BASHKIA VAU I DEJES
Shtylla e financimit (*)	“Rehabilitim, gjelbërim I mjediseve publike të bashkisë Vau I Dejes”
Programi I projektit (*)	
Emërtimi I projektit (*)	“Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim”, Zhvillimit të infrastrukturës Vendore dhe Rajonale
Data e fillimit të projektit(*)	/08/2019
Data e mbarimit të projektit (*)	/08/2019
Përshkrimi I projektit (*)	Përmirësimi dhe fuqizimi i parkut te Lanfillit, Bashkia Vau-Dejës Rehabilitimi , Gjelbërim I mjediseve publike në periferi të landfillit të Bushatit -Kushtet e mjedisit në zonë vështirësohen nga dita në ditë me rritjen e depozitimit të mbetjeve urbane të Qarqeve Shkodër dhe Lezhë. -Në kodrat e fshatit Shkejzë ku do të do të bëhet pyllëzimi ka bimësi të vogël e cila nuk e kryen funksionin e pastrimit të mjedisit “Rehabilitimi, Gjelbërim I mjediseve publike të Bashkisë Vau Dejes” -Nuk ka rrisqe negative pasi Bashkia ka marrë të gjitha masat për zbatimin e tij -Bashkia Vau Dejës ka në pronësi sipërfaqen për gjelbërim prej 6400m ²
Qëllimi dhe objektivat (*)	Me pyllëzim sipas projektit të paraqitur nga Bashkia, krijohen kushte të përshtatshme mjedisore
Numri I përfituesve (*)	Nga ky projekt përfitojnë drejtpërdrejt banor
Rendi prioritar (*)	Projekti për “Rehabilitim, Gjelbërim I mjediseve publike të fshatit Shkejzë të Bashkisë Vau Dejës” është në rendin prioritar (një).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Bashkia e Vau dejës do të ketë : -Kosto për mirmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij -Kostoja për mirëmbajtjen e objektit pas pyllëzimit do të planifikohen në Buxhetin e Bashkisë
Fondet e planifikuara (*)	Fondi I planifikuar është 11 666 666 lek pa Tvsh
Kostoja totale e projektit (*)/ Vlera që kërkohet për financim nga projekti	Sipas preventivit 14 000 000 lek me Tvsh

Projekti ka një analizë të kosto-përfitim (opsionale)	Po
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim (opsionale)	Projekti për “Rehabilitim, Gjelbërim të kurorës së gjelbër të fshatit Shkejzë” I ka parametrat për të patur një kosto të ulët në mirëmbajtjen e tij dhe plotëson kushtet bashkohore për një mjedis të pastër.
Deklarime(*)	Bashkia Vau I dejës deklaron: <ul style="list-style-type: none"> i. Projekti është gati për zbatim dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin I punimeve ii. Projekti është në listën e projekteve/ nevojave të parashikuara nga Bashkia e Vau Dejës, është e pjesë e planeve vendore të zhvillimit dhe të investimeve. Me miratimin e financimit, autoriteti kontraktues siguron pajisjen me të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e projektit, sipas legjislacionit në fuqi. iii. Janë zbatuar çmimet e e referencës për përlogaritjen e koston dhe vlerës financiare të projektit.
Dokumentat teknike, etj (*)	Projekti për gjelbërimin e objektit përmban: <ul style="list-style-type: none"> -projektin teknik -preventivin -Argumentimin teknik: -parashikimin e kostove të mirëmbajtjes së investimit i cili do të mbulohet me financim nga Bashkia duke planifikuar fonde në Buxhet.
Koordinatat e projektit (*)	X ₁ =648 259 X ₂ = 647 396 X ₃ =647 663 X ₄ =647 939 Y ₁ =381 236 Y ₂ = 381 216 Y ₃ =380 565 Y ₄ =380 500
Foto- Gjendja ekzistuese (*)	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf bashkëlidhur Projekti
Pamje 3 dimensionale (*) I detyrueshëm përveç programit Shqipëria Dixhitale	Imazhe në formatin .jpeg ose .pdf bashkëlidhur Projekti

HYRJE

Permiresimi i mjedisit minimizimi i demtimit nga procesi i zhvillimit te vendit, gjelberimi me peme dekorative ne zonat e banuara te kurores se gjelbërt të fshatit Shkejzë dhe mbrojtjen nga erozioni.

1) Te pergjithshme

Rehabilitimi I mjedisëve publike nepermjet gjelberimit me shume se dekoracion urbanistik dhe krijim peisazhi konsiderohet ne ditet e sotme si nje domosdoshmeri e lidhur kryesisht me reduktimin e ndotjes urbane dhe reduktimin e demtimeve nga erozioni.

VIZIONI

Toka roli dhe leverdia e saj universal krijojne domosdoshmerisht nje vision te qarte te trajtimit te saj me menyra dhe metoda bashkekohore dhe te moderuara per ta mbrojtur. Rritja e qendrushmerise, multifunksionaliteti, arrihet nepermjet trajtimeve te tyre specifike dhe tradicionale fillimisht me statusin aktual por gjithmone duke synuar ne strukturimin e tyre ne pershtatshmeri me nevojat e ekosistemit e deri ne krijimin e siperfaqeve te gjelberuara, te qendrueshem.

QELLIMI

Procesi i nderhyrjes per rehabilitimin e siperfaqeve te gjelberta te parkut te Lanfillit:

- Rritjen e siperfaqeve te gjelberuara.
- Permiresimin dhe ruajtjen e qendrushmerise te diversitetit biologjik dhe natyror.
- Minimizimin e fenomenit eroziv.
- Minimizimin e efektit “CO₂” (Karbon)
- Shtimin e punesimit sezonal.

KONTEKSTI I PROJEKTIT DHE OBJEKTIVAT

Ky projekt ka konceptin e nderhyrjes artificiale me bimesi dekorative ne terrene publike per ti shnderruar ne siperfaqe te gjelberuara me konsideraten gjate nderhyrjes dhe ne perspektive te kemi efektet ekologjike.

REZULTATET E PRITSHME:

- Plotesim me drure dekorativ te mjediseve publike Bashkia Vau Dejes.
- Krijimi I sip. te gjelberta te Shesheve
- Minimizimi I shperlarjes se tokes.
- Rritja e biodiversitetit dhe multifunksionalitetit te tokes.

TE DHENA

Pozicioni gjeografik.

Objekti qe merret ne studim shtrihet në periferi të kodrave të landfillit të fshatit Shkejzë Bushat.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Nr. Prev	Emertimi I objektit	Siperfaqe per gjelberim		Skema e mbjelljes				Sasia (cope)			
		ml	m ²	Drure dek	Shkurre dek	Fid Pyjore	Lule	Drur e dek	Shkurre dek	Fid Pyjore	Lule
1	Përmirësimi dhe fuqizimi i parkut te Lanfillit	0	6400	6*6	2*2		0	500	200		0

ADMINISTRIMI DHE JURIDIKSIONI

Objekti I gjelberimit eshte ne administrimin dhe juridiksionin e Bashkise Vau Dejes.

- Gjeomorfologjia e terrenit, (konfiguracioni,kundrejtimi,altitude,hidrologjia.)

Ortografia.

Sheshi I gjelberimit eshte me konfiguracion I valezuar kodrinor .

Lartesia mbi nivelin e detit 85m.

Objekti I gjelberimit ndodhet ne periferi te kodrave te landfillit Bushat fshatit Shkejzë te Bashkise Vau Dejes.

KUSHTET KLIMATIKE

Siperfaqja ne studim ndodhet ne zonen fushore te Shqiperise se Mesme dhe si e tille ajo karakterizohet nga fushe klimatike mesdhetare.

Rreshjet vjetore mesatare vleresohen midis 2200-2800 mm. Ata jane kryesisht ne formen e shirave gjate peridhes se dimrit. Rreshjet kryesisht jane ne stinen e dimrit nga muaji nentor deri ne muajin prill 70-80% e rreshjeve vjetore regjistrohen ne kete stine ndersa 15 % e rreshjeve regjistrohen ne stinen e pranveres dhe 5% ne stinen e veres. Temperatura vjetore mesatare eshte 18 grade celcius. Ne janar temperature e ajrit eshte -2 deri ne 12 grade celcius ndersa ne korrik temperatura leviz 30-38 grade.

Duke qene zone fushore fenomeni I eres nuk ndikon direkt ne kushtet klimatike sidomos gjate dimrit ku drejtimet kryesore te eres jane verilindja.

Perzgjedhja e Llojeve

Metodat e perdorura per zgjedhjen e llojeve kane qene:

- Metoda e ekologjise e krahasuar ose paralelizmi te faktoreve abiotike te mjediseve.
- Metoda e studimit te tipologjise per llojet pyjore decorative dhe e krahasimit.

Mbi bazen e dy metodave te mesiperme do te perdorim per mbjellje keta lloje:

TILIA ARGENTEA, LEILANDY, PINUS PINEA, PLATANUS ORIENTALIS DHE SHKURRE TE NDRYSHME DEKORATIVE ETJ.

KOMPOZIMI DHE SKEMA E MBJELLJES

Do te jete ne varesi te funksionit te objektit, llojit te mbjelle, me skema per druret decorative: 6x6/m, dhe 2*2m per shkurret.

MENYRA E PUNIMIT TE TOKES

Rehabilitimi nepermjet gjelberimit te mjediseve publike te Bashkise Vau Dejes duke marre parasysh poziten, shtrirjen gjeografike dhe specifikat tjera te infrastruktures, mbi te gjitha ne hapësirat e pershtatshme e te mundshme per gjelberim eshte menduar te ndahet sipas objekteve perkatese te preventivuar nga pikepamja e concept-idese kane te perbashketat dhe te vecantat e tyre ne rehabilitimin nepermjet gjelberimit.

Ne keto pjese te siperfaqeve duhet paraprire me nje angazhim me te madh ligjor dhe qytetar kryesisht per personat fizik dhe juridike qe kryejne aktivitet ne kete zone.

Realizimi i mbjelljes do te behet me skemen e parashikuar ne preventiv nga topografi duhet te filloje hapja e gropave , madhesia e tyre do te jete ne funksion te llojit te fidanit kryesisht me permasat 90x90cm (per pemet decorative) , 75x75x75cm per fidanet halor dekorativ dhe 60x60x60cm per shkurret dekorative.

Hapja e gropave do te behet me makineri profesionale me tryele per te plotesuar me se miri permasat e tyre dhe nxjerrjen e dheut ne siperfaqe pa demtuar terrenin e parapergatitur(foto e makinerise se nevojshme per hapjen e gropave).



Njekohesisht per shkuljen e cungjeve dhe drureve te degraduar per zevendesimin me dure te tjere dekorative. Shkulja e tyre do te behet me makineri profesionale pa i demtuar ato(foto e makinerise se shkuljes)



Gropat e hapura do te mbushen me dhe vegjetal sipas preventivit perkates dhe nderkohe procesi I mbjelljes do te behet duke mbushur gropen me dhe vegjetativ deri ne ate kuote sa kur te vendoset fidani ne grope niveli I dheut te fidani te jete ne nivelin e siperm te gropes.Pastaj vazhdohet te hidhet dhe vegjetal rreth e rrotull fidanit deri ne nivelin e gropes duke e ngjeshur ate me kembe.

Per rehabilitimin nepermjet gjelberimit ne mjediset publike ne kuroren e gjelbërt të fshatit Shkejzë te Bashkise Vau Dejes do mbillen druret dhe shkurret dekorative .



Pinus Pinea



Cupressus Leilandy



Bli



Thuja smarange



Tilia Argentea

KOHA E MBJELLJES.

Ne periudhe te pershtatshme per te siguar zenien dhe zhvillimin biologjik te drureve dekorativ.

METODA E GJELBERIMIT

Ne objekt do te mbillen fidane me buke dheu (vazo) ose me xogel me rrjete , diameter dhe lartesi brenda standarteve te specifikuara ne kerkesa teknike qe ndodhen ne preventiv.

Fillimisht do behet hapja e gropave ne dimensioneve sipas llojeve te percaktuara ne preventive dhe me pas behet mbjellja e tyre duke respektuar specifikimet teknike.

Per fidanet dhe shkurret dekorative mbushet gropa me dhe vegjetal deri ne mes,nxirret fidani me buke dheu nga vazo,vendoset ne qender te gropes dhe mbushet anash perseri me dhe vegjetal dhe pleh organic e ngjeshur here pas here ne zona te thata siperfaqes se gropes I jepet forme konkave ndersa aty ku toka mund te mbaje lageshtire forme konvekse.

SKEMA E MBJELLJES.PERQINDJA E ZENIES

Gjate procesit te mbjelljes ne funksion te llojit do te perdoren skema simetrike per pemet dhe shkurret sipas preventivit (drure dekorativ 6x6m dhe shkurret dekorative 2x2m)

Perqindja e zenjes duhet te realizohet ne masen mbi 85% te drureve dhe shkurreve

SHERBIME KULTURALE

Objekti ka nevojte kujdesimi pas mbjelljes te cilat do te garantojne kushte te favorshme per nje zhvillim normal te bimeve gjate viteve te para.

SPECIFIKIME TEKNIKE

- Druret dhe shkurret decorative duhet te jene te certifikuar sipas standartit kombetar nga entet perkatese me certificate Origjine dhe Fitosanitare
- Diametri i tyre duhet te jete me permasat e percaktuara ne preventiv
- Lartesia e trunget te drurit nga siperfaqja e tokes duhet te jete me permasat e percaktuara ne preventivit
- Te gjitha druret dhe shkurret qe do te perdoren per gjelberim, pyllezim duhet te sillen prane vendit ku do te implantohen(gropes) me buke dheu,te mbeshtjella me rrjete perkatese ose vazo.
- Trungu I vetekrasitur I drureve qe do perdoren per gjelberim duhet t e jete I paster pa plage dhe me procese te kallusimit natyral te perfunduara
- Per vendet (gropat) qe ndodhen ne aksin ku do te mbillen druret dekorative te cilat jane te mbushura me zhavorr ose material te tjera dhe qe nuk garantojne zhvillimin normal te drureve jane parashikuar dhe preventivuar bartje dherash vegjetal te pershtatshmem per kete qellim.

Ne kete logjike,ne te tilla vende duhet te perdoren dhera vegjetal dhe materiali qe rezulton jashte grope te transportohet ne vende te tjera ashtu si ky proces eshte prentivuar.

Risqet per nje zbatim te mundshem

Ne zbatimin me sukses te ketij projekti konsiderojme si risk disa nga problemet qe I kemi konstatuar nga verifikimet ne terren,sic jane:

- Hedhja e paligjshme e materialeve, inerteve e mbeturinave.
- Respektimi i levizjes se automjeteve brenda siperfaqes ku do te behet gjelberimi nga banoret ne afersi te objektit ku do jete shkak dentimi mekanik i pemeve dekorative.
- Respektimi I levizjes nga ana e qytetareve ne kete objekt.

Rezultatet qe priten ne zbatimin e ketij projekti

- Kthimi I ketyre objekteve ne parametrat e kerkuar duke I dhene atij identitetin e duhur te nje hapesire publike shume te rendesishme per komunitetin zones .
- Rritjen e numrit te perfituesve duke e kthyer ne nje alternative te relaksit per komunitetin.
- Rritjen e ndergjegjes dhe vetedijes se qytetareve, ruajtjen dhe zhvillimin e qendrueshem te ketij mjedisi te gjelbert duke e pare si etalon ekologjik.

PREVENTIVAT + SKICAT

1. "Rehabilitimi nepermjet gjelberimit te mjediseve publike te Bashkise Vau Dejes" Fshati Shkejze

Projektoi:

Ing _____,

Kryetari I Bashkise:

_____.



BASHKIA VAU DEJES

LANDFILLI BUSHIAC

OBJEKTI

SIPERFAQE E GJELBERUAN

463051.743
4647385.133

464422.343
4647385.133




463051.743
4646480.733

464422.343
4646480.733

Legjenda

-  Rendi 3 (Kufi Bashki)
-  Rendi 2 (Kufi Qarku)
-  Rendi 1 (Kufiri Tokësor)

<https://geoportal.asig.gov.al>: ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH